

RAPORTI VJETOR

**Për punën e SHMPK „Gjoce Stojçeski„-Tetovë
për vitin shkollorë 2024/2025**



Gusht, 2025

Tetovë

PËRMBAJTJA:

1. Karta personale e shkollës __3
2. Hyrje ____4
 - Misioni
 - Vizioni
3. Organizimi i punës së shkollës _____6
 - Pregatitja materjalo-tek
 - Organizimi i procesit edukativo arsimor
 - Realizimi i programës vjetore
 - Matura shtetërore dhe provimi përfundimtar
 - Regjistrimi i nxënësve për vitin shkollor 2024-25
4. Realizimi i mësimit _____15
 - Mësimi praktik
 - Mësimi zgjedhor
 - Mësimi plotësues
 - Mësimi shtues
 - Programet individuale për nxënës me nevoja të veçanta
 - Lidhja e eko programës me mësimin e regullt
 - Përdorimi i Tikut në mësim
 - Orët e lira dhe përmbajtje të programuara nga shkolla
5. Puna e organeve drejtuese dhe profesionale të shkollës _19
 - Këshilli drejtues
 - Këshilli i prindërve
 - Këshilli i mësimdhënësve
 - Ekipi menaxhues
 - Aktivitetet profesionale
 - Ekipi inkluziv
6. Ekskurzionet _____22
 - Burimi i finansave
 - Bashkëpunimi me mediat
7. Prioritetet _____23

1. Karta personale e shkollës:

Emir I shkollës	SHMPK „GJOCE STOJČESKI,,
Adresa , komuna, vendi	V.MILLADINOV NR.169 TETOVËS, TETOVË
Telefoni	044/350-300;350-301
Fax	044/350-301
E-mail	Tex_tekn @yahoo.com Sotu-gjocestojcheski-tetovo@schools.mk
Themeluar nga	Me vendim të këshillit Popullor të komunës së Tetovës nr.11005 data 30. 09. 1953
Verifikuar nr. Aktit / Viti i verifikimit	УП1 13-3032/1 data 10,06,2020 УП1 13-2260 data 29,12,2020 УП1 13-3032/5 data 10,06,2020 УП113-3032/3 data 10,06,2020 УП113-3032/4 data 10,06,2020 УП113-3032/2 data 10,06,2020 УП1 12-2503/2015 data 11,05,2016
Gjuha mësimore në të cilën realizohet mësimi	Shqip
Viti i ndërtimit	1953
Lloji i ndërtimit	Ndërtesë
Hapsira e objektit	1,622m/2
Hapsira e oborit të shkollës	4.650 m/2
Hapsira e fushave dhe tereneve sportive	650m/2
Shkolla punon me ndrime	Dy ndrime
Mënyra e nxemjes së shkollës	Nxehmje qendrore
Numri i klasave	19
Numri i paraleleve	36paralele
Numri i ndrimeve	2

2. Hyrje:

SH.M.P.K “Gjoce Stojçeski”, është formuar më 30.09.1953 me vendim të Këshillit popullor të komunës së Tetovës. Nga data 07.12.2005 me ligjin për decentralizim të pushtetit dhe ligjit për ndarje teritoriale, shkolla kalon në shkollë të mesme publike komunale me proces verbal Nr. 03-1541/1 me datë 07.12.2005.

Në vitin shkollor 2024/2025 SH.M.P.K. “Gjoce Stojçeski”-Tetovë vepron si shkollë e mesme profesionale-publike, komunale me tre drejtime themelore të shkallës së IV-ër arsimore si vijon:

I. Drejtimi / Sektori tekstile-lëkurë me profilet / kualifikimet arsimore:

- Teknik për përpunimin e veshjes(I,II,III,IV) УП1 13-3032/1 data 10,06,2020
- Teknik për modelim të veshjes (I,II,III)УП1 13-2260 data 29,12,2020
- Teknik për dizajn të veshjes(I,II,III,IV) УП1 13-3032/5 data 10,06,2020

II. Drejtimi / Sektor kimi-teknologji me profilet / kualifikimet arsimore:

- Teknik i laboratoritkimi(I, II, III, IV) УП113-3032/3 data 10,06,2020
- Teknik ushqimor(I,II,III,IV) УП113-3032/4 data 10,06,2020
- Teknik për mbrojtjen e ambientit jetësor(I, II, III, IV) УП113-3032/2 data 10,06,2020

III. Arsimi artistik/Art figurativ dhe dizajn

- Dizajner për enterier, mobilje dhe prodhime industrialet .(I,II,III,IV) УП1 12-2503/2015 data 11,05,2016

- **Misioni:**

Kuptimi i egzistencës së shkollës sonë është pregaditja e kuadrove profesionalisht me njohuri bashkëkohore dhe eksperiencë e cila i bënë të aftë për tu inkuadruar në prodhim si dhe edukim për të vazhduar shkollimin sipëror në lëmitë përkatëse.

- Motoja e shkollës

EDUKIM , FUQI

E-ENERGJI **F-FITUES**
D-DITURI**U-UDHËRËFYES**
U-URTESI**Q-QËNDRUESHMËRI**
K-KREATIVI-INICIATIVË
I-I MATUR
M-MOTIVUES

Shkolla e Mesme Profesionale Komunale „Gjoce Stojçeski„-Tetovë është institucion edukativo arsimor në të cilin shkollohen dhe edukohen të rinj të cilët të pamvarur përgatiten për jetën në të ardhmen me qëllim të bëhen profesionist në profilin e caktuar dhe të kyçen në prodhimtari. Shkolla jonë u mundëson nxënësve paralelisht të përfitojnë dituri bashkëkohore , mësim praktik , punë të punëdhënësi dhe ushtrime laboratorike të cilat i përsosin dhe u mundësojnë që të bëhen konkurent në tregunë punës.

- **Vizioni:**

Pregaditja e kuadrove të reja profesionale të cilët njohurit dhe aftësit e fituara gjatë shkollimit katërvjecar mund ti zbatojnë në proceset e punës dhe prodhimit e bënë shkollën tonë një partnere me respekt në jetën sociale të qytetit tonë dhe më gjërë. Gjithashtu shkolla jonë ka kapacitet të mundëson përsosjen profesionale të kuadrove më të vjetra. Shkolla jonë nga dita në ditë aftësohet për zbatim të teorisë **“MËSIM TËRË JETËN”** duke bërë trajnimin permanent të kuadrit edukativo-arsimor më metodat e reja mësimore dhe zbatim të teknologjive të reja në mësim dhe praktik.

3. Organizimi i punës në shkollë:

- **Pregatitja materjalo teknike:**

Mjetet mësimore janë faktor kryesor për realizim të sukseshëm të qëllimeve dhe detyrave edukativo arsimore. Furnizimi me mjete mësimore ndihmëse sjell deri tek rritja e aktivitetit të nxënësve dhe rritje të kualitetit të mësimin, realizimi i programeve mësimore dhe aritja e suksesit më të mirë.

Shkolla disponon me :

Mjetet mësimore janë faktori rëndësishëm për realizim të sukseshëm të qëllimeve , detyrave dhe procesit edukativo arsimor. Furnizimi me materiale mësimore dhe ndihmëse sjell deri te rritja e aktivitetit të nxënësve , ngritja e kualitetit të mësimdhënies-mësimnxënies , realizimi i programeve mësimore dhe me të aritja e një suksesi më të mirë.

Shkolla posedon me :

7 kompjuter dhe 7 printera për nevojat administrative dhe në vitin 2024-25 jemi paisur me kompjuter dhe laptop të rinjë për administratën.

1 projektor dhe 1 laptop për nevojat e shërbimit pedagogjik

2 projektora për nevojat e kuadrit mësimor

2 tabela të mençura në studio të dizajnit dhe kabinet të informatikës

1 proektor statik në studione dizajnit

30 kopjuterat për nevojat e nxënësve

4 printera për nevojat e kuadrit mësimor dhe nxënësve

2 fotokopje të mëdhaja për nevojat e mësimdhënësve dhe nxënësve

Kët vit shkolla ka bërë blerjen dhe regullimin e :

Lyerja e mureve brenda shkollës.

Lyerja dhe riparimi i hyrjes dhe koridorit në sallën sportive

Riparim dhe lyerje e kabinetit për nevojat e drejtimit ushqimor (në vazhdim është në pritje ardhja e donacionit të një kuzhine dhe materjaleve tjera për nevojat e këtij drejtimi.)

Rregullimi komplet i oborit dhe parqeve para dhe pas shkollës

Riparim i një hapsire për psikolog dhe pedagog dhe dhe furnizimi me të gjitha mjetet materjalo teknike të nevojshme për punën e pandërprerë të shërbimit profesional(tavolina pune, shkafe, rafte etj.)

Paisje me mjete didaktike

- Organizimi i procesit mësimor

Procesi edukativo arsimor në ShMPK,, Gjoce Stojçeski,, -Tetovë në vitin shkollor 2024-25 është realizuar sipas kalendarit për organizim të mësimit për vitin shkollor 24-25 e sjellur nga MASH e RMV.

Viti mësimor ka filluar me datë 01.09.2024a gjysvjetori i parë ka mbaruar me 31.12.2024

Pushimi dimëror për nxënësit ka filluar me 01.01.2025 dhe ka zgjatur deri me 21.01.2025. Gjysvjetori i dytë ka filluar me 22.01.2025. Viti mësimor për nxënësit e viteve të katërta mabroi me 20maj a për nxëxnësit tjerë ka mbaruar me 10 qershor.

Para fillimit të vitit akademik janë bërë këto përgatitje:

Përgatitja e programit vjetor për punën e shkollës, shpërndarja e orëve sipas lëndëve mësimore, shpërndarja e drejtuesve të klasave, ndarja e përgjegjëseve (mësuesit përgjegjës të aktiveve profesionale, komisionet për zhvillimin e provimeve edhe . komisione tjera), përgatitja e orareve të klasave, përgatitja e orarit për mësimin plotësues dhe shtues, përgatitja e planifikimit global dhe tematik ku janë të përfshira edhe përmbatjet e ekostandardet.

Veprimtarinë edukative në shkollë e zhvillojnë drejtori i shkollës, ndihmësdrejtori, psikologu, pedagogu, sociologu, bibliotekari, 65 mësues dhe 4 laborantë.

Planprogramet vjetore, globale dhe tematike janë përgatitur dhe dorëzuar nga të gjithë mësuesit.

Drejtuesit e klasave monitoruan suksesin, rregullsinë dhe disiplinën e nxënësve, bashkëpunuan me drejtorin dhe shërbimin profesional. Me prindërit janë mbajtur më së paku 4 mbledhje me prindëri për secilën klasë dhe në secilin vit. Drejtori i shkollës zbaton detyrat dhe aktivitetet e planifikuara në Programin Vjetor të Punës së shkollës, programin e punës së

Drejtori dhe aktualitetet e tjera që u realizuan nga bashkëpunimi me Drejtorinë e Arsimit, MAS, BRO, OSHC dhe komunitetin më të gjerë shoqëror.

Në vazhdim të punës, drejtori së bashku me bashkëpunëtorët profesional vizituan një numër të madh paralelesh për të monitoruar zbatimin e mësimdhënies, metodat aktive të mësimdhënies dhe teknologjinë TIK dhe aftësitë e tjera që mësuesit i fituan në procesin e përhershëm, zhvillimin profesional dhe udhëzimin e realizuar pedagogjik, biseda me mësuesit. Drejtori ndoqi dhe mori pjesë nëpunën gjithpërfshirë në shkollë: proces edukativo-arsimor, tekniko-material kushtet e punës, politikat e personelit, financiare etj.

Psikologu, pedagogu realizuan detyrat e planifikuara nga programi i punës, në mënyrë të pavarur dhe së bashku me drejtorin vizituan një numër të madh klasash dhe kryen detyra të tjera të vazhdueshme: morën pjesë në planifikim dhe kryerjen e punës së përgjithshme arsimore, morën pjesë në përgatitjen e raporteve statistikore dhe të tjera, punë pedagogjike-mësimore me mësimdhënësit dhe mësuesit praktikantë, punë në komisione, punë në organet profesionale, projektet dhe përmirësimet. Ata zhvilluan një numër të madh bisedash këshilluese individuale dhe grupe me nxënës dhe prindër.

Psikologu, pedagogu realizojnë këshillimin për prindërit e atyre nxënësve që tregojnë sukses të dobët, kanë mungesa ose tregojnë sjellje të papërshtatshme. Ai ka realizuar edhe aktivitetet e parapara sipas planit dhe planeve të veprimit për tërë vitin për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.

- **Realizimi i programës vjetore për punë:**
Aktivitete, aktivitetet jashtëmësimore, projekte, trajnime, seminare dhe puntori të realizuara përgjatë gjithë vitit shkollor për mësimdhënësit, puntorët profesional dhe nxënësit.

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE 2024-2025

18-19.09.2024- Trajnimi 6. Shkathtësit bazike për shkrim lexim digjital në klasë

07-10.10.2024- Realizimi i pilot testimit PISA (ku mëson pjesë të tri grupeve të moshës 15 vjeçare që i takojnë periudhës prej 01.01.2008 - 31.12.2008)

01.09.2024-31.03.2025- Evidentimi i nxënësve që marrin vlerëtime për shtesa arsimore nga projekti i kushtezimit financiar - projekt i mbështetur dhe finansuar nga banka botërore.

25.10.2024- Trajnim lidhur me standardet dhe treguesit e cilësisë për evaluimin e punës së Kordinatorit për arsimin praktik.

-21.10.2024-projekt I realizuar nga përfaqësues nga Sektori për Punë të Brendshme me temë „Mos ngit automjetin pa leje dhe pa provimin e dhënë, respektoni rregullat dhe rregulloret në komunikacion, mbron vetë dhe të tjerët. U realizua me nxënësit e viteve të dyta në hapsirat e shkolles.

-TRAJNIM-Korrik-2024 me temë: Standardet dhe treguesit e cilësisë për evaluimin e punës së kordinatorit për arsimin praktik. Pjesëmarrës Prof. Afrim Berisha

-TRAJNIM I realizuar nga fondacioni për iniciativë arsimore dhe kulturore „Hap pas hapi, i cili u realizuan në hapsirat e Shoqatës që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara „Hendimak“, i mbajtur me 6,7,8,27-11.2024 me nxënësit Arife Haziri dhe Shkëlqim Jaja nxënës të vitit të katërt, asistentja Lirije.

08.11.2024-Dhurim vullnetar i gjakut me nxenesit eviteve te katerta ne lokalet e shkolles.Duhet te theksojm se numri ii te interesuarve per dhurim vullnetar te gjakut ishte i madh .

19.11.2024-Ne shkollen tone ishin perfaqshues te Avokatit te popullit te cilet organizuan ligjerat si dhe ankete me nxenesit viteve te treta.

29.11.2024-Debat publik metemë „Shkaqet dhe situata me migrimin e të rinjëve nga rajoni i Pollogut,,

Projekti u realizua nga Asociacioni për iniciativa demokratike-Gostivar,Asociacioni instituti për lidërsip dhe politika publike ,Qendra për edukim dhe zhvillim, Asociacioni instituti për ndryshime sociale InSOK- Tetovë.

Pjesmarësishin 10 nxevititte dyte,6 nxviti katert,8 nxvititrete se basdhku me psikologendhesociologen.

Trajnim I mbajtur me 03.12.2024 ne Hotel SITI PARK –SHKUP me teme;Cilesiadhematja e cilesis _standardetdhetreguesit per matjen e cilesis se punes se kordinatorit per temesuarit perms punes.

Pjesmaresprof.Afrim Berisha

2024-Projekti rajonalpërsigurimine cilësisësëpunëssëkordinatorëvetëndërlidhjessëpunës, Ku kanë marrë pjesë zëv.ministri i arsimit Lulzim Aliu, ambasadori i R.Austrisë z.Martin Pamer, drejtori i Qendrës së APT-së si dhe z.Elizabet Ogustin, udhëheqëse e departamentit e OeAD dhe Madalena Kominçini, kordinatore arsimore austriake-OeAD. Trajnimi u mbajt në Hotelin Aleksandar Palas në shkup. 03, 04.12.2024- Në kudër të projektit,,Sigurimi i kualitetit në punën e kordinatorit të të mësuarit përmes punës te punëdhënësi” ështëmbajturtrajnimidydtor me temën: Kualiteti dhe matja e kualitetit – standardet dhe indikatorët për matjen e kualitetit të punës së Kordinatorit për mësimin përmes punës. Trajnimi është realizuar në hotelin Siti park në Shkup Nga shkolla e jonë ka marrë pjesë kordinatori i shkollës prof.Afrim Berisha

18,12,2024-Projekti rajonal per sigurimin e cilesis se punes se kordinatorve te nderlidhjes se punes ,ku kane mare pjese zev,ministri i arsimit Lulzim ALIU.ambasadori i R,Austrisz,Martin PAMER ,drejtori i Qendresse APT-se si dhe z.Elizabet Ogustin udheheqes ne departamentin e OEAD dhe Madalena Komincini kordinatore arsimore austriake.

Drejtorja e teardhuravepublike(DAP)shprehmirenjohje per nxenesit per bashkpunimin ne realizimin e aktiviteteve te edukimit tatimordhekontributune cmuar ne pergatitjen e videove educative, permes krijimit te tyre ne nendheqjen dhe mbështetjen e profesoreve dhe drejtuesve te shkolles.

Puntori educative e mbajtur me 12.12.2024 ne hotel Liraku TETOVE ,organizuar nga Fondacioni KVINNA –SUEDI,Rjeti Nacional kunder dhunes ndaj grave dhe dhunes ne familje dhe Qendres psikoterapike CORTEX.Pjesmares psikolog-Berenika Qamili,pedagog- Zedije Idrizi.

Me 17.01.2025 u realizua ekspozita nganxenesit e shkolles tone me emrin,, Njeco pe arti,,Ekspozita u realizua jashte vendit, ne Republiken e Shqiperis ,ne presidencia.Pjesmaresishin njegrupenxenesish ,professor dhe kryetari I komunes me stafin e tij.

25.02.2025-Trajnim rajonal per ngritjen e kapaciteteve per zbatimin e Agjendes se Gjelber ne nivel lokal,perrajonin e Pollogut te Republikes se Maqedonise se Veriut.Trajnimi u realizua ne hapsirat NB KOMPANI – TETOVE kupjesmaresishin perfaqesues te sektorit civil dhe institucioneve lokale.

Pjesmares ngash kollajone ishte prof Skender Skenderi.

Me 25.02.2025 –Ne sallën e konferencave ne hotel Merkur u mbajt Panel diskutimi me teme,,Per miresimi I sistemit te mbrojtjes se viktimave te dhunes me bazegjinore dhe ne familje,,

Panel diskutimi u organizua nga Shoqata e Psikologeve,Keshilluesve dhe psikoterapeuteve ,,Cortex,, -Tetove.Pjesmaresishin shefi I kabinetit te komunes se Tetoves –Basri Mehmedalia , Svetlana Cvetkovska -udheheqese e sektorit per mundesite barabarta, Ana Avramoskakordinatore e projektit Rrjeti Nacional kunder dhunes dhe psikolog pedagog te shkollave filllore dhe temes me.

20,03,2025- Takim I kordinatorit te shkolles tone me profesoret te cilet realizojn lenden;TE MESUARIT PERMES PUNES TE PUNEDHENESI me kete rend dite .1.njoftim reth memorandumeve te bashkpunimit me kompanit ,2.zgjidhje e problemeve gjate procesit te te oreve te TMPP.

04.04.2025-ne kuaderteprojektit „ATA JANE NE per femijet me nevojandryshe ,grupijoformal I terinjeveRinia e zeshme ,organizoi session pergatitor ne hapsirat e ish-Radio Tetoves ,kuteftuarishinpsikolog,pedagog,sociologteshkollavetemesmedhedhenganjenxenesprejsecilit vit.

18.04.2025-SHKOLLA VERORE JURIDIKE „NE LIGJI DHE E DREJTA,, -Pjesmarespedagog,sociologydhenxenesestevititte pare.

29.04.2025- vizite ne ditet e hapura ne Panairin per Kariere ne UT.Pjesmarespsikologia me nxenesit e vitetvetetretadhevitet e katertagjithsej 20.

29.04.2025 .Vizite me nxenesit ne ekspozite ne QIK(qendra informative kulturore)neSHkup .

30.04.2025-Panel diskutimi me teme:„Rendesia e barazisegjinore ne parandalimindhunesndaj grave dhevajzave,, I mbajtur ne Europe House-Tetove.Pjesmares :psikolog ,pedagog.

14.05.2025-Seminar I Psikologjis me teme: „Mlreqenjadhesjellja e rezikshmetekadoleshentet,,irealizuar ne hapsirat e UT.Pjesmarespsikologudhedynxenes.

14.05.2025-Vizite ne shkollen tone perfaqsesdhenxenesngashkollafillore „NaimFrasheri,,

16.05.2025-Panel public me teme:„Arsimi ne udhekryq :A po pergatisimterinje per teardhmen?

Pjesmares :peseperfaqsesngashkollajone.Urealizua ne hapsirat e universitetitteevropesjuglindore

19.05.2025-Ligjerat educative e mbajturngaQendra e SHendetit Publik- Tetove ne hapsirat e shkolles tone me teme:„Duhanidheefektet negative ne organizem,, kuligjeruesishteDr.specialist Faton Ademi,dhetepranishemishin 120 nxenesngategjithavitet.

- **Matura shtetërore dhe provimi përfundimtar- SHTOJCAT**

REGJISTRIMI I NXËNËSVE NË VITIN E PARË PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026-SHTOJCA

4. Realizimi i mësimit

Mësimi i rregullt në të gjitha lëndët është realizuar në pajtueshmëti me plan-programet mësimore . mësimdhënësit kanë përgatitur dhe dorëzuar në kohë të gjitha programet tematike dhe ditore

- Mësimi praktik

Në pajtim të zhvillimit të punës praktike në shkollën tonë gjatë viti shkollorë janë marrë masat që vijojnë:

- Shfrytëzim racional të parkut të makinave në punëtorit egzistuese
- Zbatim më të plot të njohurive të reja teorike në mësimin praktik
- Angazhimi në procese prodhimi
- Bashkëpunim me ndërmarjet :
- **Drejtimi Kimi teknologji:** Renova , Green Product , Veze Sharri, Bukëpjekës Arena , Vitamil, Ëmbëltorja Dudu Teqe, Zhito Pollog, Hit 73.
- **Drejtimi Tekstil lëkurë dhe sektore tjera:** Salon Rrobaqepsie Hava, Maleri Grup, Misioni-DOOEL, Di-Simone RS, Elita Inex, Imperial HTT.
- **Drejtimi artistik:**diyajneri i enterierit,mobiljeve dhe prodhimeve industriale: Mobileri Alba
- Pjesmarje në revistë të modës dhe gara shkollore
- Bartës të aktiviteteve: drejtorja dhe mësimdhënësit e punës praktikve.

- **Mësimi zgjedhor**

Mësimi zgjedhor u realizua në vit të III-të me fond javor prej 1 ore dhe të IV-t me fond javor prej 1 ore, në bazë të planprogrameve të reformuara të sjellura nga QSHMP, të miratuara nga MASH

Drejtimi tekstil-lëkurë

TEKNIK I PËRPUNIMIT TË VESHJES	LËNDËT ZGJEDHORE	
MODULI	III	IV
KONSTRUKTIM KOMPJUTERIK I VESHJES	KONSTRUKTIM KOMPJUTERIK I VESHJES	KONSTRUKTIM KOMPJUTERIK I VESHJES
KUJDESI NDAJ VESHJES		KUJDESI NDAJ VESHJES
PROCESI TEKNOLOGJIK I PËRPUNIMIT TË VESHJES		PËRPUNIMI I VESHJEVE MBROJTESE
LËNDË TË PËRGJITHSHME	MATEMATIK KIMI	MATEMATIK KIMI

TEKNIK PËR MODELIM TË VESHJEVE	LËNDËT ZGJEDHORE	
MODULI	III	IV
PËRPUNIMI DHE KUJDESI I VESHJES	PËRPUNIMI I VESHJES	KUJDESI NDAJ VESHJES
FORMËSIMI ESTETIK		DIZAJNIMI I MODELEVE PËR KOLEKSION
LËNDË TË PËRGJITHSHME	MATEMATIK	MATEMATIK

TEKNIK I DIZAJNIT TË VESHJES	LËNDËT ZGJEDHORE	
MODULI	III	IV
ART DHE DIZAJN	DIZAJNIMI I MATERIALEVE TË TEKSTILIT	PËRPUNIMI I AKSESORVE TË MODËS
PROCESET PRODHUSE DHE TEKNOLOGJIKE		PËRPUNIMI I VESHJEVE SOLEMNE
MODULE TË PËRGJITHSHME ARSIMORE	MATEMATIKA	MATEMATIKA

Drejtimi kimi - teknologji

TEKNIK I MBROJTJES SË AMBIENTIT JETSOR	LËNDËT ZGJEDHORE	
MODULI	III	IV
KIMI TOKSIKE	SUBSTANCAT HELMUSE	ALKALOIDET DHE DROGAT
MATERIALET TEKNOLOGJIKE TË SË ARDHMES	NANOMATERIALET	BURIMET ALTERNATIVE TË ENERGJIS
HULUMTIMET KIMIKE NË MJEKSI	HULUMTIMET FORENZIKE	KIMI KLINIKE
ORGANIZIMI IPUNES	SJELLJA ORGANIZATIVE	BIZNES DHE SIPËRMARËSI
MODULI IPËRGJITHSHEM ARSIMOR	BIOLOGJI INFORMATIK	KIMI MATEMATIK

TEKNIK I LABORATORIT KIMIK	LËNDËT ZGJEDHORE	
MODULI	III	IV
KIMI TOKSIKE	SUBSTANCAT HELMUSE	ALKALOIDET DHE DROGAT
MATERIALET TEKNOLOGJIKE TË SË ARDHMES	NANOMATERIALET	BURIMET ALTERNATIVE TË ENERGJIS
HULUMTIMET KIMIKE NË MJEKSI	HULUMTIMET FORENZIKE	KIMI KLINIKE
ORGANIZIMI IPUNËS	SJELLJA ORGANIZATIVE	BIZNES DHE SIPËRMARËSI
MODULI I PËRGJITHSHËM ARSIMOR	INFORMATIK BIOLOGJI	MATEMATIK KIMI
TEKNIK USHQIMOR	LËNDËT ZGJEDHORE	
MODULI	III	IV
PRODHIMI I PRODHIMEVE USHQIMORE	ADITIVET, MËLMESAT DHE PIJET	YNDYRNAT, VAJRAT DHE PRODHIMET ME PREJARDHJE SHTAZORE
NUTRICIONIZMI	PERGATITJA DHE TRAJTIMI I PRODHIMEVE USHQIMORE	DIETETIKA
ORGANIZIMI IPUNES	SJALLJE ORGANIZATIVE	BIZNIS DHE SIPËRMARËSI
MODULET E PËRGJITHSHME	FIZIK INFORMATIK	MATEMATIK KIMI

- **Mësim plotësues**

Për të gjithë nxënësit të cilët gjatë tërë vitit shkollor kanë treguar sukses të dobët është organizuar mësim plotësues në bazë të orarit të përgatitur paraprakisht.

- **Mësim shtuesë**

Për nxënësit që kanë treguar sukses të dalluar në lëndë të caktuara është organizuar mësim shtues me kërkesë të nxënësit.

- **Programe individuale për nxënës me nevoja të veçanta**

Për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta kemi përgatitur plane akcionale përmes të cilëve mësimdhënësit e kanë realizuar mësimin

- **Lidhja e EKO-programës me mësimin e rregullt**

Secili mësimdhënës i lëndës në planprogramin e tij vjetore ka pasur sëpaku 3 standarde të përgatitura.

- **Përdorimi i TIK-ut në mësim**

Çdo profesor në planprogramet mësimore ka pasur të paraparë realizimin e procesit mësimor përmes teknologjisë informative, sëpaku 30 % e orëve mësimore.

- **Orët e lira dhe përmbajtje të programuara nga shkolla**

Në kornizë të orëve të lira janë realizuar këto orë të lira të miratuara nga QSHMP të cilat janë evidentuar në ditar nxënës të janë notuar, por nota nuk ka hyrë në mesatare të suksesit:

- Vitit i parë,, Trashëgimia botërore në duart e të rinjve,,
- Vitit i dytë,, Planifikim për karrierë,,
- Viti i tretë,, Përgatidja për punë dhe punësim,,
- Viti i katërt,, Kërkimi aktiv i punës,,
- Viti katër,, Shkathtësi prezantuese,,

Koha e realizimit: Gjatë tërë vitit shkollorë realizohen nga mësimdhënësit të lëndëve të përgjithshme

- **Përmbajtje të programuara nga shkolla** janë ato programe të cilat i përgatitin vet mësimdhënësit dhe i miraton Qendra për shkollë të mesme profesionale dhe i realizojnë mësimdhënësit e mësimi profesional

5. Puna e organeve drejtuese dhe profesionale të shkollës.

- Këshilli Drejtues i shkollës

Antarët e Këshillit Drejtues të shkollës:

Përfaqësues të Këshillit të Mësimdhënësve: Hurije Sh., Aleksandra S, Luljeta A.S., Sulejman N.-kryetarë

Përfaqësues të Këshillit të prindërve:: Rexhep Muharemi, Selver.O ,Radije I

Përfaqësues nga Këshilli i Komunës: Shpresa R., Doruntina M., Larita R.

Përfaqësues të MASH: Sasho M.

Përfaqësues nga komora e zanatçinjëve: Samet Z.

Bordi i shkollës, i përbërë nga anëtarët e lartpërmendur, në të gjitha seancat e mbajtura miratoi: Programin vjetor të punës së shkollës për vitin shkollor 2025/2026, raportin e punës së shkollës për vitin shkollor 2024-2025. Raport për kryerjen e evidentimit të mjeteve dhe gjendjes financiare. Llogaria përfundimtare, miratoi planin vjetor për të ardhurat publike ,miratoi planin vjetor financiar të shkollës, ndoqi rezultatet e nxënësve, ofroi mbështetje për sigurimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, realizoj çështje të tjera të përcaktuara me statutin e shkollës etj.

- Këshilli i Prindërve:

Bashkëpunimi me këshillin e prindërve është zhvilluar vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Prindërit u informuan drejtpërdrejt dhe u përfshinë në të gjitha aktivitetet e shkollës. Këshilli i prindërve shqyrtoi çështjet e jetës dhe punës së shkollës në fund të çdo tremujori, shqyrtoi suksesin, rregullsinë dhe sjelljen e nxënësve, bashkëpunoi me drejtorin, mësuesit, psikologin dhe mori pjesë në punën e Bordit të shkollës me përfaqësuesit e tij.

Në takimet e rregullta, ata shqyrtuan gjendjen dhe zbatimin e mësimin, duke përfshirë edhe temën e sigurisë së nxënësve në rrjetet sociale, si dhe emëruan përfaqësuesin e tyre në Ekipin e Sigurisë në bashkëpunim me MPB-në. Pavarësisht se siguria është në nivel të lartë falë masave të marra, rekomandohet që prindërit, nxënësit dhe mësuesit në aktivitetet e tyre të përditshme të theksojnë nevojën për tolerancë dhe respekt më të madh të ndërsjellë ndërmjet të gjitha palëve të përfshira në procesin arsimor.

- Këshilli i mësimdhënësve të shkollës:

Këshillat e mësimdhënësve të klasave mbajtën 4 mbledhje, nga dy për gjysëmvetor . Në mbledhje u vlerësua suksesi, rregullshmëria dhe sjellja e nxënësve, u vendosën masa pedagogjike, mësimdhënësit bashkëpunuan me Këshillin e prindërve dhe propozuan masa për tejkalimin e problemeve me rregullshmërinë dhe disiplinën e nxënësve.

Këshilli i mësimdhënësve i shkollës mbajti mbledhje ku u vlerësua suksesi, rregullshmërinë dhe disiplinën e nxënësve, u shqiptuan masa pedagogjike dhe u dhanë lëvdata për nxënësit .

Në takime u shqyrtuan: Raporti Vjetor i Punës, Programi Vjetor, Rregulloret, lutjet, informacione të ndryshme, situata aktuale dhe çështje të tjera aktuale. Psikologu realizoi detyrat e parapara nga programi i punës, në mënyrë të pavarur dhe së bashku me drejtorin dhe ndihmës drejtorin, vizituan një numër të madh paralelesh dhe kryen detyra të tjera të vazhdueshme: Morën pjesë në planifikimin dhe programimin e gjithë punës edukative-arsimore. morën pjesë në përgatitjen e raporteve statistikore dhe të tjera, në punën pedagogjike - mësimore me mësimdhënësit dhe mësimdhënësit praktikantë, punën në komisione, punën në organet profesionale. Ata zhvilluan një numër të madh bisedash këshilluese individuale dhe grupe me nxënës dhe prindër. Psikologu realizoi këshillimin psikologjik për prindërit e atyre nxënësve që tregojnë sukses të dobët dhe kanë mungesa.

- Ekipimenaxhues i shkollës:

Shkolla në vitin shkollor 2024-25 është udhëhequr nga drejtor Muzafer Livoreka dhe Ndihmës drejtor Sulejman Fetai.

Mësimi është realizua në dy ndrime , në shkollë funksionon edhe shërbimi profesional i përbërë nga psikolog Berenika Qamili, Pedagog Zudije Idrizi , sociolog Vjosa Zeqiri.

Pjesa administrative e shkollës funksionon me një Sekretar Nexhmije Ibraimi, Arkëtar Nexhat Osmani dhe dy mësimdhënës përgjegjës nga një për ndrim për ndrimin e parë Besim Sallai . dhe ndrimi i dytë Rilind H.

- Aktivet profesionale

Mësimdhënësit janë të grupuar në këto aktive profesionale:

- Gjuhë shqipe
- Gjuhë maqedone
- Gjuhë të huaja
- Informatikë
- Art figurativ

- Sociologji dhe histori
- Kimi
- Tekstil dhe
- Matematikë

Aktivet profesional në kohë kanë përgatitur raport të punës për vitin e kaluar shkollor, plan për punën e viti të ardhshëm. Aktivet i kanë realizuar këto aktivitete:

- Përgatitje të planeve globale, tematike dhe disa plane tjera operative në pajtueshmësi me qasjen metodologjike në realizimin e mësimin.
- Realizimin e orëve plotësues për nxënësit me sukses të dobët
- Realizimi i mësimin shtues për nxënësit me sukses të shkëlqyeshëm
- Pjesëmarrjen e nxënësve në gara të ndryshme
- Aktivi i kimis dhe tekstilit kanë mbajtur mbledhje për përzgjedhjen e firmave ku nxënësit e kanë realizuar mësimin praktik , të mësuarit përmes punës tek punëdhënësi dhe praktikën feriale.

- Ekipi Inkluziv:

Në fillim të vitit shkollor nga ana e drejtorit të shkollës është formuar ekipi inkluziv për të realizuar procesin inkluziv të nxënësve me nevoja të veçanta. Përgjatë gjithë vitit shkollor në mënyrë të vazhdueshme kishte bashkëpunim në mes shërbimit profesional, nxënësve, mësuesve dhe prindërve të këtyre nxënësve me qëllim përgatitja e planeve individuale arsimore për secilin nxënësi , adaptimin e suksesshëm dhe socializimit me nxënësit e klasës shkollën dhe mjedisin. Këtë vit kemi pasur 9 nxënësi me nevoja të veçanta për të cilët kemi siguruar 7 asistent arsimor

6. Ekskurzionet

Këtë vit shkollor janë realizuar disa ekskurzione me karakter edukativ. Nxënësit e vitit të tretë kanë vizituar Qytetin e Durrësit ,kurse në muajin maj kanë vizituar Qytetin e Strugës. Në maj për vitet përfundimtare është organizuar edhe mbrëmja e maturës.

7. Burimet e finansave.

Mjetet finansiare të shkollës sigurohen nga buxheti i parapar në nivel të shkollave të mesme nga Komuna e Tetovës dhe nga mjetet vetanake të shkollës.

8. Bashkëpunimi me mediat.

Për bashkëpunim me media shkolla ka qenë e hapur për të gjitha mediumet elektronike dhe të shtypit të cilat kanë shfaqur interes për bashkëpunim me shkollën tonë përmes shpalljes në televizionet e tyre të aktiviteteve të realizuara përgjatë vitit shkollor

Raportin e përgatitën:

Ndihmës drejtor-Sulejman Fetai

Psikologu i shkollës- Berenika Qamili

Pedagogu i shkollës-Zudije Idrizi

Sociologu i shkollës-Vjosa Zeqiri

U.D.Drejtor
Muzafer Livoreka

Gusht, 2025

Kryetari i Këshillit Drejtues
Larita Rexhepi
